



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

TEATRI KOMBËTAR I OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR  
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE  
SEKTORI I SHËRBIMEVE

Nr. 1485 Prot

Tiranë, më 01/12/2023

**NJOFTIM**

Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambilit Popullor, në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi Punës i RSH”, i ndryshuar; Ligjit Nr.10 352, datë 18.11.2010 “Për Artin dhe Kulturën” i ndryshuar; VKM-së Nr. 176, datë 29.03.2006, “Për botimin e buletinit të njoftimeve publike”; Urdhër të Kryeministrit nr 140, datë 28.03.2014 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së TKOBAP-së”; Statutit të Institucionit të TKOBAP miratuar me urdhër të Ministrit të Ministrisë së Kulturës nr. 166, datë 27.04.2015 neni 15 gërma c; Rregullores së Brendshme “Për Organizimin dhe Funkcionimin e TKOBAP-së” me nr.1850 prot datë 25.07.2014, shpall vendin vakant për pozicionin e punës:

**-Orkestrant Kategoria e Parë (instrumenti fizarmonikë) në Sektorin e Orkestrës pranë Drejtorisë Artistike të Ansambilit të Këngëve dhe Valleve Popullore.**

**-Kandidati/ja duhet të plotësojë kushtet për konkurim si vijon:**

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejon të kryejë detyrën e provuar me dokumentacionin përkatës;
4. Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
5. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtje penale me dashje e certifikuar nga shteti;
6. Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore.

**Audicioni për këtë vend vakant do të mbahet në sallën e orkestrës së DAAKVP brenda ambienteve të TKOBAP në datën 15/12/2023, ora 09:00.**

**Ë gjithë artistët që janë të interesuar për t'iu nënshtruar audicionimit, duhet të dorëzojnë pranë zyrës së protokollit të Institucionit të TKOBAP-së deri në datën 08.12.2023, ora 14:00 dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:**

**Dokumentacioni:**

1. Të jetë diplomuar në Akademinë e Arteve-dega Fizarmonikë (preferohet në nivelin Master);
2. Të njohë mirë karakteret popullore të Shqipërisë së Mesme, të Veriut dhe të Jugut;
3. Të ketë eksperiencë në koncerte, recitale ose në masterclass-e;
4. Preferohet që kandidatët të jenë deri në moshën 35 vjeç me qëllim uljen e moshës mesatare të artistëve që janë pjesë e Sektorit të Orkestrës të Drejtorisë Artistike të Ansamblit të Këngëve dhe Valleve Popullore.

\*Mosparaqitja e plotë dhe në kohë e dokumentave sjell skualifikim të kandidatit.

**Programi artistik:**

1. Shkallë sol+ me relativet
2. Arpezhet
3. Një pjesë e lirë për nga vetë konkurenti
4. Lexim "A prima vista"
5. Vallja "Vallëzim Qypave"
6. Vallja "Vallja e Kosovës, Rrugova"
7. "Valle Tek Burimi"
8. Kënga "Isha vetëm tu mendu, qënke veshur me të bardha"
9. Kënga "Te desha me hakikat"
10. Kënga "Bishtalecat"
11. Kënga "Hapi syte e zezë"
12. Kënga "Hajredin Pasha"

shënim:

- Komisioni ruan të drejtën që të dëgjojë të gjithë ose një pjesë të programit të konkursit.

Për sqarime të mëtejshme, ju lutem mos hezitoni të na kontaktoni në adresën:  
[sekretaria@tkob.gov.al](mailto:sekretaria@tkob.gov.al)

**DREJTORE E PËRGJITHSHME**

**Abigejla VOSHTINA**

